

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

### PLANET SHPK

Sot më datë 25 Qershor 2019 ("Data e Kontratës") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

#### Nga njëra anë:

1. **Znj. Armida Kosta**, shtetase shqiptare, lindur më 17.02.1976, në Diber, mbajtëse e Passaportes me nr. personal H65217070C, dhe nr. BG5524898 këtu e në vijim referohet si "**Shitësi**"

në praninë e:

**Z. Sokol Kosta**, shtetas shqiptar, lindur më 06.07.1977, në Kuçovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal H70706117T dhe nr. pasaporte BE9567503 (bashkëshorti i Shitësit).

Dhe

2. **Znj. Eneda Kosta**, shtetase shqiptare, lindur më 29.11.1982, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I26129040O dhe nr. 032959596, në vijim referohet si "**Blerësi**")


Dhe

3. **Z. Gentjan Kole**, shtetas shqiptar, lindur më 27.08.1973, në Kuçovë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H30827046P dhe nr. 028497795 në cilësinë e palës së tretë me detyrime në këtë kontratë.

#### Duke qenë se:

- A. Shitësi zotëron një kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar dhe të paguar të shoqërisë "PLANET" sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 10.06.2005, me numër NIPT K51810504P dhe seli në Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, Tiranë ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 5.000,00 (pesë mijë) lekë.
- B. Blerësi dëshiron të blejë kuotën e Shitësit që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar dhe të paguar të Shoqërisë ("**Kuota**") dhe Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi, Kuotën sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate.

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:



**1. OBJEKTI I KONTRATËS**

- 1.1** Objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit në Shoqëri nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate të përcaktuar në hyrje të saj ("**Data e Kontratës**").
- 1.2** Pronësia e Kuotës kalon tek Blerësi në përputhje me kushtet dhe detyrimet e kësaj Kontrate dhe Kuota do të shitet dhe blihet së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me to në Datën e Kontratës por pa përfshirë të drejtën mbi pjesën takuese të dividendit të padeklaruar dhe/ose pashpërndare për fitimin e vitit ushtrimor 2018 në masën 498.886,00 LEK). Blerësi, në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë do të sigurohet që Shoqëria të shpërndajë dhe paguajë pjesën takuese të dividendit të Shitësit në masën 498.886,00 LEK brenda datës **1 Korrik 2019** në llogarinë bankare të njoftuar nga ky i fundit në adresën e-mail të administratorit/ortakut Eneda Kosta.
- 1.3** Me kalimin e pronësisë së Kuotës në pronësi të Blerësit, kapitali i Shoqërisë do të zotërohet tërësisht nga ortaku i vetëm i Shoqërisë në masën 100%.

**2. ÇMIMI I BLERJES SË KUOTËS DHE MËNYRA E PAGESËS**


- 2.1** Çmimi i Kuotës që do të paguhet nga Blerësi është 13.500 EURO ("**Çmimi i Blerjes**").
- 2.2** Kjo shumë do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitësit njoftuar nga ky i fundit në adresën e-mail të Blerësit menjëherë pas clirimit të depozitës së Shoqërisë pranë bankës së nivelit të dytë në masën 27.000 EUR për garancinë IATA, por në cdo rast jo më vonë se **brenda 30 ditëve nga Data e Kontratës**.
- 2.3** Shitësi ka përgjegjësinë e vetme për të paguar cdo tatim në lidhje me Çmimin e Blerjes.


**3. KALIMI I PRONËSISË SË KUOTËS**

- 3.1** Pronësia mbi Kuotën në Shitje i kalon Blerësit në përputhje me Nenin 1.1.

**4. DEKLARIMET E GARANCITË E SHITËSIT**

- 4.1** Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("**Garancitë e Shitësit**") në vijim janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Kontratës:
- 4.2** Shitësi gëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.3** Kuota në pronësi të Shitësit përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- 4.4** Kjo kontratë përbën një detyrim të vlefshëm ligjor mbi Shitësin dhe të detyrueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj.
- 4.5** Nuk ekzistojnë garanci, instrumenta të tjerë të konvertueshme në kuota ose marrëveshje të tjera që sjellin ndonjë të drejtë mbi Kuotënqë të jenë nënshkruar nga Shitësi.



- 4.6 Nuk ekziston ndonjë marrëveshje, rregullim apo detyrim për të krijuar ose për të dhënë barrë në lidhje me Kuotën dhe asnjë person nuk ka pretenduar dhe nuk ka të drejta për barrë për ndonjë nga Kuotat në Shitje.

## 5. DEKLARIMET E GARANCITË E BLERËSIT

- 5.1 Blerësi gëzon të gjitha të drejtat, autoritetin dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

- 5.2 Z. Gentjan Kole, si palë e tretë që ka interes në këtë Kontratë, merr përsipër që të sigurojë brenda 1 muaji nga nënshkrimi i kontratës kalimin e domein-eve: *spirit.travel*; *flyspirit.eu*; *cët.al*, *bufi.al*, *ifly.al*, *myplanet.al* të cilat garanton se janë të regjistruara në emër të tij, përkatësisht tek shoqëria "SPIRIT TRAVEL & TOURS" sh.p.k, me numër NIPT L32403002P ("Spirit") në rastin e domainave *spirit.travel*; *flyspirit.eu*; *cët.al*, *bufi.al*, tek shoqëria "iFLY" sh.p.k, me numër NIPT L42324011C ("iFly") në rastin e domainit *ifly.al* dhe tek Shoqëria ("Planet") në rastin e domainin *myplanet.al*. Për këtë qëllim, Z. Gentjan Kole merr përsipër të kryejë cdo veprim që është në varësi të tij për të kryer kalimin por cdo pagesë tek ofruesi i domaineve (nëse ka pagesa te tilla) për kalimin e domainave si më lart, do të përballohet nga shoqëritë e sipërpërmendura ose Blerësi, sipas gjykimit të këtij të fundit.

Gjithashtu, Z. Gentjan Kole, merr përsipër që brenda 1 muaji nga nënshkrimi i kësaj kontrate të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe administrative për heqjen dorë nga regjistrimi ose transferimin e aplikimit për regjistrim tek Spirit dhe Planet (persa kohe transferimi është i mundur ligjorisht) te markave "Spirit TRAVEL & TOURS" "bufi.al" dhe "myplanet" për regjistrimin e të cilave ka aplikuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) por të cilat janë ende në proces ekzaminimi. Të gjitha kostot administrative në lidhje me depozitimin e heqjes dorë/transferimit të pagueshme ndaj DPPI, do të përballohen nga Blerësi. Gjithashtu, Blerësi, do t'i rimbursojë Z. Gentjan Kole shumën prej 1000 EUR të paguar prej këtij të fundit si shpenzime ligjore dhe administrative për aplikimin e regjistrimit të markave në emër të tij në të njëjtën kohë me veprimet e transferimit/heqjes dorë nga regjistrimi si më lart.

## 6. KOSTOT

- 6.1 Secila Palë merr përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjorisht ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës në Shitje.
- 6.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës në Shitje, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve, duke përjashtuar detyrimet që i lindin vetëm Shitësit sipas Nenit 2.3 të përcaktuar në këtë kontratë.

## 7. LIGJI I ZBATUESHËM



7.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.

## 8. JURIDIKSIONI

8.1 Cdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

## 9. TË NDRYSHME DHE SHITESA

9.1 Asnjë ndryshim, shtesë ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve.

9.3 Palët bien dakord se në rast se Z. Gentjan Kole nuk përmbush detyrimet e parashikuara në Nenin 5.2 të cilat janë në ngarkim të tij, kjo Kontratë do të konsiderohet e pavlefshme dhe palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme, përpara nënshkrimit të Kontratës.

9.4 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës.

## 10. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

10.1 Kjo Kontratë hartohet në disa kopje në gjuhën shqipe, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

SHITËSI

Armanda Kosta



Gentjan Kole  
guly

Sokol Koster  
Oy

BLERËSI

ENEIDA KOSTA

